



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	19.07.2023 <i>01-011/01-16533</i>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës <i>Ardian Gjini</i>
Lënda:	Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - me numër të parcelës P-70705008-00396-6

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 58 pika (a) dhe (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të formimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, e parashtrohet në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM - VENDIM

1. Kuvendi i Komunës të formojë Komisionin Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, së bashku me objektet përcjellëse që gjenden në parcelën me numër P - 70705008 – 00396 - 6, Z.K Berkoc, e cila është në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar.
3. Ky Komision Vlerësues ka mandat për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës një (1) të këtij propozim vendimi.

Me respekt!